



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Adresa: Perandori Justinian, PN, Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë 14 Maj 2010
Ref .nr.17/10

VENDIM
për vazhdimin e masës së përkohshme

në

Lëndën Nr. KI 56/09

Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë

vs.

Kuvendit Komunal të Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë prej:

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtar
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

Parashtruesit e Kërkesës janë Z. Fadil Hoxha dhe 59 Të Tjerë nga Komuna e Prizrenit.

Pala kundërshtare

Pala kundërshtare është Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Objekti i çështjes

1. Objekti i çështjes së lëndës është kërkesa për vënien e masës së përkohshme me 17 tetor 2009 në Lëndën KI.56/09, paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, Fadil Hoxha dhe 59 "Kryefamiljarë të Lagjes Dardania".

2. Me 25 nëntor 2009, Gjykata Kushtetuese, pas procesit të këshillimit, arriti në përfundimin, duke mos paragjykuar rezultatin përfundimtar të Kërkesës, se Parashtruesit e Kërkesës kanë paraqitur argumente bindëse të mjaftueshme për të justifikuar lejimin e kërkesës për masa të përkohshme, sepse implementimi i Vendimit Nr. 01/011-3257 i datës 30 prill 2009 (më tej: Vendimi i 30 Prillit 2009) nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit mund të rezultojë në dëme të pakthyeshme për Parashtruesit e Kërkesës.

3. Në vijim, me 15 dhjetor, Gjykata Kushtetuese lëshoi Vendimin, i cili lejon vendosjen e masës së përkohshme për një kohëzgjatje jo më shumë se tre (3) muaj, duke urdhëruar pezullim të menjëhershëm të përmbarimit të Vendimit të datës 30 prill 2009, si dhe pezullimin e çfarëdo lloji ndërtimi në zonën e "Jaglenica" në Prizren për të njëjtën kohëzgjatje.

4. Më 15 mars 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi të lejojë vazhdimin e kërkesës për masë të përkohshme për 45 ditë.

Bazat juridike

5. Neni 116 (2) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej : Kushtetuta), Neni 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2009 (më tej : Ligji), dhe Neni 52 (1) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese (më tej : Rregullorja).

Faktet

6. Me anë të Vendimit Nr. 01/011-3257 të datës 30 prill 2009 nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, një Vendim i mëparshëm për Planin Detal Urban (PDU) për lagjen Jaglenica (tani Dardania) është ndryshuar (Vendimi i 30 prillit 2009). Këto ndryshime, në pjesën përkatëse, specifikohen në Nenin 2 të Vendimit të datës 30 prill 2009, dhe lexohet për sa vijon: "Në pjesën grafike të planit teknik në zonat kadastrale..., në vend të një mjedisi ekzistues të gjelbër, të paraparë në PDU, tani është paraparë ndërtimi i pallateve të larta, planifikuar për familjet e dëshmorëve dhe rastet sociale..."

7. Me 13 korrik 2009, Parashtruesit e Kërkesës dorëzuan një Peticion në Kuvendin Komunal të Prizrenit, në të cilën kërkohej anulimi i Vendimit të datës 30 prill 2009. Në veçanti, ata argumentuan se Vendimi i kontestuar është miratuar në kundërshtim me Nenet përkatëse të Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor (Nr.2003/14) dhe Ligjit Mbi Vetë-Qeverisjen Lokale (Nr.03/L-040).

8. Me 11 shtator 2009, Parashtruesit e Kërkesës dorëzuan një Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën kërkohej që Gjykata të vlerësonte kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e Vendimit të datës 30 prill 2009.

9. Me 17 tetor 2009, Parashtruesit e kërkesës plotësuan Kërkesën me argumente shtesë dhe i kërkuan Gjykatës vendosjen e masës së përkohshme dhe të urdhëronin Palën Kundërshtare të pezullonte menjëherë çdo lloj veprimi ose punë në ngastrën e tokës në fjalë, me qëllim që të shmangen dëme të pariparueshme.

10. Deri tani, Kuvendi Komunal nuk e ka konsideruar Peticionin e parashtruesve të kërkesës, paraqitur me 13 korrik 2009.

Ankesat e parashtruesve të kërkesës

11. Parashtruesit e Kërkesës u ankuan se të drejtat e tyre që garantohen me Nenin 52(2) të Kushtetutës janë shkelur, i cili siguron se: 'Secilit duhet t'i jepet mundësia të dëgjohet nga institucionet publike dhe mendimet e tyre të konsiderohen lidhur me çështjet që kanë ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë'.

12. Parashtruesit e Kërkesës janë ankuar më tej se ekziston një rrezik i menjëhershëm se punimi në ngastrën e tokës në fjalë do të shkaktojë dëme të pariparueshme tek ata dhe prandaj i kërkuan Gjykatës të vendosin masa të përkohshme me efekt të menjëhershëm.

Komentet e Palës Kundërshtare

13. Kuvendi Komunal i Prizrenit, në parashtresën paraqitur me 11 nëntor 2009, kontestoi pretendimet e Parashtruesit të kërkesës që ishin paraqitur në kërkesë. Në veçanti, Pala kundërshtare argumentoi se Vendimi i 30 prillit 2009 u miratua në pajtueshmëri me Ligjin e planifikimit hapësinor dhe ngastra e tokës në fjalë është klasifikuar si pronë publike, e cila i jep të drejtën Kuvendit Komunal të Prizrenit të ndjekë një zhvillim të balancuar dhe gradual të planifikimit hapësinor të ngastrës së tokës.

14. Më 16 prill 2010, Kuvendi Komunal i Prizrenit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor kundërshtoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese për vazhdimin e masës së përkohshme për 45 ditë. Pala kundërshtare argumentoi në veçanti se Plani Rregullues Urbanistik "Dardania 2", i miratuar me Vendimin 01/011-3756 të datës 17 korrik 2009 ishte hartuar në përputhje me bormat dhe standardet urbane.

GJYKATA KUSHTETUESE

15. Më 30 prill 2010, Gjyqtari Raportues, z. Altay Suroy i propozoi Gjykatës Kushtetuese vazhdimin e masës së përkohshme edhe për dy muaj të tjerë. Gjykata, pas procesit të këshillimit në të njëjtën datë, arriti në përfundimin se duke mos paragjykuar rezultatin përfundimtar të Kërkesës, të lejojë vazhdimin e kërkesës për masë të përkohshme për një periudhë tjetër prej dy muajve, prej 30 prillit 2010.

PËR KËTO ARSYE

Sipas Nenit 116(2) të Kushtetutës, Nenit 27 (1) të Ligjit dhe Nenit 52(1) të Rregullores së Punës, Gjykata, me shumicë votash,

VENDOS

I. TË LEJOJË VAZHDIMIN e Masës së Përkohshme për dy muaj të tjerë, duke filluar nga data 30 prill 2010;

II. TË ZGJASË PEZULLIMIN E MENJËHERSHËM të përmbarimit të "Vendimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit të Planit detal urban në Lagjen e Jaglenicës, në Prizren, miratuar nga Kuvendi Komunal me 30 prill 2009 sipas Nr. 01/011-3257, për të njëjtën kohëzgjatje;

III. TË ZGJASË URDHËRIN dhënë Kuvendit Komunal të Prizrenit që të pezullojë çfarëdo ndërtimi në vendin e mësipërm për të njëjtën kohëzgjatje;

IV. Ky Vendim do t'ju njoftohet Palëve;


V. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me Nenin 20(4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues


Altay Suroy



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani